

Nr.prot,

Datë / /2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstrukcion rrjeti TM, kabina, linja TU me kabëll ABC për fiderat Ujësjeles, Maricaj, Miniera 1, Miniera 2, Nst Memaliaj 110/6 kV; fiderat Dragot dhe Kalaja Nst Tepelenë 110/10 kV dhe fiderat Petran, Qyteti dhe SMT në Nst Përmet 110/10 kV dhe kabina Fushë Libohovë, fideri Zagorie Grapsh”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 31321000-2
Linja të energjisë elektrike.

VLERA E FONDIT LIMIT: 149,994,409.83 *(njëqind e dyzet e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntë pikë tetëdhjetë e tre)* lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga “Të Ardhurat” e Autoritetit Kontraktor.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76,82 dhe 83 të LPP (i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 12.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i përditësuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **50 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga i gjithë bashkimi në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në pune të percaktuara në aktmarreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotësojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë projektin.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 i ndryshuar (Ligji nr. 126/2024) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga i gjithë bashkimi në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në punë të përcaktuara në aktmarreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar **Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar** “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke

paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 10091/2009 i ndryshuar (*Ligji nr.126/2024*).

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore **të maturuara për vitin 2026** (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bisnesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr. 8 të DST-së. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën Nr. 8 të DST-së.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, (i Ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.P. 1- B Punime gjurmimi në tokë;
- N.P- 11- D Ndërtime për n/stacionet, kab transformacionit, linjat TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
-

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.S –18 - A Punime topogjeodezike.

*Ne rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, Licencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsiper punimet për të cilat kerkohet Licenca Profesionale.

*Kur Operatori Ekonomik është i huaj, ai duhet të paraqesë licencën e ekivalentuar me kategoritë e kerkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt. Si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P1	Punime gërmimi në tokë	Germim dheu për gropë shtyllash T/L, në tokë të fortë kat IV, ~2.5 m, sipërfaqja 1.5m ² . Germim kanalesh në tokë të fortë, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² . Shtrese zhavori lumi t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Shtrese çakelli mbeturinë kave t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Prerje asfalti me disk, në të dy anët. Prishje shtresa betoni. Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjatësi deri 2 m, në tokë të fortë, kategoria III, me shkëlqim në mjet. Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, në tokë të fortë. Prishje mur tulle pa pastrim. Prishje suvatim muri i brendshëm. Mur me tulla të plotë të fortë, deri 3m, llaç perzier M 25	B	21-50 milion lekë
N.P11	Ndërtim për N/stacione, kabina, transformatorë, linja TN e të mesme dhe shpërndarje e energjisë	Montim "Box" parafabrikat (2l+1t) (box parafabrikat përfshin: kabinën parafabrikat me permase 4.2X2.2,h=2.2m, bazamentin e kabines 4.2X2.2,h=0.6m, setin e pajisjeve TM / TU, tokëzimi	D	101-200 milion lekë

		i brendeshem ,ndricimi pa transformatorin e fuqise), Montim Transformatorë të fuqisë ÷ 560 kVA, 20/10/6/0.4 Kv, Matje kontroll i transformatoreve te fuqise 6kV,10kV,20kV,35kV (kolaudim), Lidhje e ures kabllore TM/TU ne izolatorete e transformatorit. Matje kontroll i Çelave te linjes, te transformatorit TM 20 kV (Kolaudim). Drejtim shtylla të centrifuguara betonarme (me makineri). F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x95mm².		
N.S -18	Punime topogjeodezike	Piketim i vendosjes së shtyllave, (F.V. Në tokë kabëll fuqie 20 kV alumin unipolar (flat), me izolim XLPE, (1x185) mm²),piketimi i vendosjes se kabinave të reja tip box etj...	A	0-20 milion lekë

2.3.3 Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- EN-ISO 9001: (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001: (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- ISO 45001: (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent
- ISO 50001: (Sistemi i menaxhimit të Energjisë) ose ekuivalent

*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues.

*Operatori ekonomik mund të paraqesë certifikatat e mesiperme sipas standardeve shqiptare mbi konformitetin e standartit europian dhe të leshuara nga organizma të vlersimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mesiperme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për certifikatën e cilësisë së prodhuesit ISO 9001, në rast se OE ofertues nuk është prodhues duhet të paraqesë vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK ka të drejtën të kërkojë paraqitjen e certifikatës të cilësisë të prodhuesit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar me ligjin 16/2024) dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), citon: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Njësia e Prokurimit vendosi të kërkojë certifikatat e mesiperme për të vërtetuar cilësinë e punimeve që do të kryen nga OE fitues. Certifikatat e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe respektojnë parimin e mosdiskriminimit.

Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001: e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues është i certifikuar për produkte dhe punime të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të veçantë për kryerjen e kësaj kontrate. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi duhet të kryejë punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet që mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate.

Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të Energjisë ISO 50001: është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës, veprimtarinë dhe përdorimin e pajisjeve për të cilat duhet të ketë një siguri që nuk shpërdorojë energjinë e nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Me anë

te ketij certifikimi, identifikohen dhe menaxhohen rreziqet që lidhen me furnizimin e ardhshëm të energjisë, mundësohet matja dhe monitorimi i përdorimit të energjisë për të identifikuar se ku të përmirësohet efikasiteti. Po ashtu do të përmirësohet performanca e përgjithshme për të ulur konsumin e energjisë, etj.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse e stafit inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder/ Gjeomatik

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike.

Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Në lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Për sa më sipër, është e nevojshme që Operatorët ekonomikë të pasqyrojnë referenca të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndërtimit : është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me germimet Mbushje, rafshim,ngjeshje e tokes, si dhe çdo punim tjetër që ka lidhje me ndërtimin e kanalit ku do të vendoset kablli TM/TU dhe cdo punimi tjeter per rikonstruksionin e kabinave,.etj
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: është përgjegjës për percaktimin e saktë të gjurmës së shtrirjes të linjës dhe piketimin e vendit të vendosjes se kabinave të reja dhe shtyllave.

- Inxhinieri Elektrik : është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me shtrirjen e kabllit në kanal, ndërtim i linjave me kabell ABC , realizimin e terminaleve 20kV, realizimin e lidhjeve elektrike të çelave 20kV, transformatorit të fuqisë, matje dhe kontroll i materialeve elektrikeetj

2.3.5 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem.

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

VKM Nr.42 date:16.1.2008 “Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”-kreu IV,pika 1/a dhe ligjit nr.8402 date 10.9.1998 ”Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”,neni 8 ku citohet:

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. "Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Mjeku mund të jetë me kohe të plote (i brendshëm) ose me kohe të pjesshme (i jashtëm) referuar numrit të punonjësve bazuar në VKM Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar).

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 42 (dyzet e dy) punonjës**. Afati i punimeve duke gjykuar mbi natyrën dhe volumin e punimeve do të jetë **12 muaj**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohej nga legjislacionin tatimor për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

2.3. 8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **19 (nëntëmbëdhjetë)** punonjës elektrikist, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, me kontratë pune të vlefshme, dëshmi profesionale, ku minimalisht **5 (pesë)** prej tyre të jenë të pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit teknik (të vlefshme).

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit, dhe afatit 12 muaj për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin zë, u llogarit shifra prej 42 punonjës.

*Mbështetur në rekomandimin e APP –së me nr.5168 prot, dt.18.07.2024 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimi për mallra, punë, shërbime”, në të cilën kërkohet të argumentohet nëpërmjet analizës teknike numri i kërkuar i punonjësve, **Grupi i Projektimit ka analizuar zërat e preventivit duke nxjerrë orët e punës për secilin zë duke u konsultuar me sistemin SIM (e-albania).***

Në total rezultuan 89031.9916 orë pune. Këto orë pune u pjestuan 174 orë pune në muaj dhe u pjestuan me 12 muaj (afati i realizimit), duke sjellë rezultatin prej 42 punonjësish + 5 punonjës stafi menaxherial (3 inxhinierët + administratori i shoqërisë + mjeku).

- Njësia e Prokurimit vlerëson se të paktën 19 punonjës duhet të jenë elektrikist (referuar orëve të punës me natyrë elektrike 39791 orë në total), ku minimalisht 5 (pesë) prej tyre të jenë të pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit teknik (të vlefshme).

39791 orë pune elektrike ÷ 174 orë pune në muaj ÷ 12 muaj = 19 punonjës që do të kryejnë punë të natyrës elektrike.

Këto dëshmi duhet të kërkojnë për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

- Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë: 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) Inxhinier Ndertimi, 1 (një) Inxhinier Gjeodet /Topograf/ Markshajder/ Gjeomatik, që të mbikqyrin punimet në fazën e zbatimit. Këta inxhinier kanë lidhje edhe me licencat profesionale që duhen për zbatimin e projektit.

- Në përcaktimin e numrit të punonjësve, Njësia ka bërë një analizë bazuar tek kategoritë e punimeve, terrenit, kualifikimi i punonjësve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje prej 3 muajsh nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në rast se mjete e punës (makinerite) janë në pronësi të operatorit.

Ne rastet kur makineritë **disponohen me qira**, nuk eshte e nevojshme qe manovratorët e mjeteve te figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Në këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe dëshmitë e drejtimit.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	MJETET	SASIA	GJENDJA
1	Autovinc deri 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
2	Autovinc deri ne 2.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Vinc Kulle 0.5 – 1 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Rul (Kompresor) me Vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
5	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Teraometer për matjen e rezistencës së tokëzimit	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Kenotron per kablllo	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Ekskavator 0.25 m3	1 copw	Pronwsi ose me qera
9	Tokmak elektrik	1 copw	Pronwsi ose me qera
10	Autovinç 16 ton	1 copw	Pronwsi ose me qera
11	Betonjere 500 liter	1 copw	Pronwsi ose me qera
12	Buldozer S-80/100 KF	1 copw	Pronwsi ose me qera
13	Rul thike	1 copw	Pronwsi ose me qera
14	Vinc kulle 4-6 T	1 copw	Pronwsi ose me qera
15	Vinc kulle 6-10ton	1 copw	Pronwsi ose me qera
16	Makineri per sperkatje me bitum	1 copw	Pronwsi ose me qera

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Për mjetet e përmendura mësipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi përkatëse.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

1. Preventivat janë hartuar sipas Manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim referuar VKM Nr.216 date 13.04.2023.
2. Hartimi i preventivave për rastin kur zeri i punës nuk është në manualin e çmimeve, do të hartohet si analizë jashtë listen e sistemit.
3. Orët e punës për hartimin e analizave të reja teknike jashtë liste i referohen librit 6 “Montimi i linjave dhe Nënstacioneve” dhe librit “Manual Preventivimi për rrjetat elektrike komunale”.
4. Çmimet për materialet dhe makineri pajisje që nevojiten për hartimin e analizave jashtë liste i referohen çmimeve pa TVSH të SAP OSSH sha, studimit të tregut ose çmimeve të kontratave të mëparshme të realizuara në OSSH sha.
5. Në këtë preventiv nuk janë llogaritur vlerat për mbikqyrje, kolaudim , leje ndertimi.etj
6. Materialet e nxjerra nga gërmimi ,duhet të transportohen në vend depozitimi të miratuara . Në rrugë të asfaltuara dherat largohen plotesisht .
7. Zonat e punimeve do të konsiderohen si zona kantieri dhe duhet të zbatojnë legjislacionin përkatës mbi rregulloren dhe sigurinë në kantier.
8. Të gjitha materialet që do të përdoren në objekt të jenë në perputhje me specifikimet teknike të dhëna.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative.

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Autovinc deri 5 ton - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.04-M, 4.02-M .

Mjeti Autovinc 16 ton – Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.05-M.

Autovinc deri ne 2.5 ton - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.183.

Vinc Kulle 0.5 – 1 ton - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.10-M; 4.09-M .

Rul (Kompresor) me Vibrim - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.205/2, 3.212/b.

Grejder - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.206, 3.183/a.

Ekskavator 0.25 m3- Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.89/a; 3.88/a; 3.87/a.

Tokmak elektrik - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.47/1a; 3.47/1b.

Betonjere 500 liter – Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.243.

Buldozer S-80/100 KF - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.548/2; 3.550/2.

Rul thike - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.19.

Vinc kulle 4-6 T - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 2.262/4; 2.262/3; 2.331.

Vinc kulle 6-10 ton - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 2.166.

Makineri per sperkatje me bitum - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 3.969/2.

Teraometer për matjen e rezistencës së tokëzimit - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.37.

Kenotron per kablo - Kërkohet në preventiv dhe në manualin e-albania, në portalin SIM në kodin 4.189.

2.3.11 Për Listën e mëposhtme të artikujve:

- *Kabell XLPE 20kV AL (sipas specifikimeve teknike)*
- *Kabine parafabrikat tip Box (sipas specifikimeve teknike)*
- *Cele TM 20 kV me SF6 (sipas specifikimeve teknike)*
- *Transformator Fuqie (sipas specifikimeve teknike)*
- *Kabell TU me vetmbajtje ABC (sipas specifikimeve teknike)*
- *Kabell koaksial (sipas specifikimeve teknike)*
- *Shtylla B/A (sipas specifikimeve teknike)*
- *Panel TU (sipas specifikimeve teknike)*
- *Litar Alumin çelik (ACSR)*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga te cilat specifikimet teknike te produkteve te kerkuara te jene ne gjuhen e ofertes.*
- *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit, per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

- *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi të kryera me pare, që vertetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mesiperme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.*

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

2. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerësit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

3. Kjo kërkesë në lidhje me testimet zyrtare është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Së pari, paraqitja e dëshmive të testeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standartet e kërkuara.
- Së dyti, kriteri për dëshmitë të testeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e dëshmive të testeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

Specifikimet teknike, projekti, relacioni teknik, preventivi me zërat e punimeve janë pjesë e pandarë e DST.

Sqarim: Çdo kriter i parashikuar në nenin 26, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në shtojcën nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, përmbushet nga Operatorët Ekonomikë nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST.

Në bazë të nenit 26, pika 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së (i ndryshuar), dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH sh.a Drejtoria Qendrore dhe **deleguar me shkresën Nr. 5176 prot, 08.05.2026**, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar me ligjin nr.16/2024).*

Për çdo specifikim teknik të artikujve (bashkëlidhur në PDF) në të cilin kërkohet paraqitja e certifikatës së prodhuesit ISO 9001, në rast se OE ofertues nuk është prodhues duhet të paraqes vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK rezervon të drejtën për

verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK ka të drejten të kërkojë paraqitjen e certifikatës të cilësisë të prodhuesit.

Me termin “*të gjithë test raportet*” e përcaktuar tek *specifikimet teknike*, AK kërkon testimet për secilin material sipas specifikës së tyre në përputhje me standartet referuese (sipas materialeve bashkëlidhur në SPE).

Ato duhet të jenë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave për të vlerësuar në mënyrë korrekte cilësinë e mallit.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga:

1. Eneida KOKO Person përgjegjës për prokurimet
2. Letisja ARAPAJ Anëtar
3. Orlando RUSTEMI Anëtar